



AKTGJYKIMET E PARA NË MUNGESË PËR KRIMET E LUFTËS

BULETIN | MAJ 2026

AKTGJYKIMET E PARA NË MUNGESË PËR KRIMET E LUFTËS

BULETIN | MAJ 2026

Gjykimet në mungesë për krime lufte në Kosovë janë bërë të mundura pas një serie ndryshimesh ligjore në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Këto ndryshime synojnë të mundësojnë ndjekjen penale të personave të dyshuar për krime lufte edhe në rastet kur ata nuk janë të pranishëm në territorin e Kosovës.

Baza ligjore për këto gjykime u krijua fillimisht në korrik 2019, me miratimin e Ligjit nr. 06/L- 091 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, i cili për herë të parë mundësoi gjykimin në mungesë për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare penale të kryera gjatë periudhës janar 1990 - qershor 1999.

Më pas, në vitin 2021 dhe 2022, dispozitat ligjore u plotësuan dhe u saktësuan më tej përmes ndryshimeve të reja dhe hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale, i cili në mënyrë të qartë rregullon kushtet për zhvillimin e gjykimeve në mungesë.

KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMEVE NË MUNGESË

Sipas nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale, gjykimi në mungesë për krimet e luftës mund të fillojë vetëm nëse gjykata vlerëson se janë ndërmarrë përpjekje të arsyeshme për njoftimin e të akuzuarit dhe për sigurimin e pranisë së tij në procedurë.

Këto përfshijnë: dërgimin e thirrjes për paraqitje në gjykatë; lëshimin e urdhër-arrestit nga gjykata; verifikimin e adresës së të pandehurit; shpalljen e letër-rreshtimit; zhvillimin e fushatave informative për dorëzimin e të akuzuarit.

Po ashtu, ftesa për paraqitje në gjykatë dhe aktakuza publikohen në faqen e Prokurorit të Shtetit, në faqen e gjykatës kompetente dhe në Gazetën Zyrtare.

Në këto raste, i akuzuari përfaqësohet nga një mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare gjatë gjithë procedurës penale dhe gëzon të drejtën për rigjykim automatik dhe të pakushtëzuar nëse paraqitet më vonë para drejtësisë.

Aktakuza e parë në mungesë për krime lufte në Kosovë është ngritur më 2 maj 2023. Që nga ajo kohë, prokuroria ka intensifikuar përdorimin e këtij mekanizmi për ndjekjen penale të rasteve të krimeve të luftës.

Deri në fund të vitit 2025 janë ngritur gjithsej 24 aktakuza në mungesë kundër 120 pjesëtarëve të forcave serbe. Vetëm gjatë vitit 2025 janë ngritur 10 aktakuza kundër 55 personave.

AKTGJYKIMET E PARA NË MUNGESË

Aktgjykimi i parë në mungesë u shpall më 26 dhjetor 2024 kundër Çedomir Aksiqit, i cili u dënua me 15 vjet burgim për krime lufte kundër popullatës civile. Megjithatë, më 10 nëntor 2025, Gjykata e Apelit e anuloi këtë aktgjykim dhe e ktheu rastin në rigjykim për shkak të mosplotësimit të disa kushteve procedurale për fillimin e gjyimit në mungesë, përfshirë mungesën e një fushate të plotë informative.

Gjatë vitit 2025 janë shpallur edhe dy aktgjykime të tjera në mungesë nga gjykata e shkallës së parë kundër Sllavisha Filliqit i dënuar me 15 vjet burgim dhe kundër Ivica Rajkoviçit dhe Dragan Deniqit të cilët u dënuan me nga 15 vjet burgim secili, për krimet e luftës kundër popullatës civile.

1. PROKURORI KUNDËR ÇEDOMIR AKSIQIT

Gjykata e Apelit në datën 10 nëntor 2025 e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priština me të cilin është dënuar me 15 vite burgim i pandehuri Çedomir Aksiq për veprën penale krimet e luftës kundër popullatës civile dhe rastin e ka kthyer në rigjykim në shkallën e parë.

RRJEDHA E PROCEDURËS

Në datën 2 maj 2023, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) e ka ngritur aktakuzën për gjykim në mungesë kundër Çedomir Aksiqin për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.

I pandehuri Aksiq akuzohet se në periudhën kohore janar - maj 1999, gjatë periudhës së konfliktit të armatosur në Kosovë, në bashkëryerje me persona të tjerë, të veshur me uniforma policore, paramilitare dhe ushtarake ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim të integritetit trupor ose të shëndetit dhe frikësim të popullatës civile shqiptare, në atë mënyrë që:

- Në fillim të muajit prill, në pikën "Kodra e Gështenjave", e cila gjendet në mes të Shtimes/Štimlje dhe fshatrave Mollopolc/Malopoljce, Reçak/Raçak dhe Petrovë/Petrovo, i pandehuri ka marr pjesë në dëbimin, në vrasje dhe djegie të shtëpive të Ruzhdi Jashari, Sadri Jashari, Rexhep Jashari dhe Hamdi Jashari në rrugën "Sylejman Vokshi" në Shtime/Štimlje.

- Në periudhën kohore, përkatësisht në datën 13 dhe 14 maj të vitit 1999, në vendin e quajtur "Lugu i Neshës", në fshatin Petrovë/Petrovo të Shtimes/Štimljes, i pandehuri, në bashkëryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim të integritetit trupor ose të shëndetit, frikësim të popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërim për zhvendosje të popullatës civile, ashtu që, derisa i ndjeri Halil Hysenaj ka qenë së bashku me familjen e tij duke qëndruar në mal, i pandehuri ia kishte drejtuar armën të ndjerit Halil Hysenaj, i cili më pas është gjetur pa shenja jete.

- Në datën 15 janar të vitit 1999, në fshatin Reçak/Raçak të Komunës së Shtimes/Štimlje, i pandehuri, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim të integriteti trupor ose të shëndetit, frikësim të popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërim për zhvendosje të popullatës civile, ashtu që ka marrë pjesë në vrasjen e Hajriz Brahim-it, Haki Muratit, Sabri Muratit, Arif Muratit, Ahmet Mustafës, Sadik Mujotës, Hanumshahe Mujotës, Skender Halilit dhe Mehmet Mustafës.

Prokuroria ka propozuar që pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština të mbahet gjykimi në mungesë kundër të pandehurit Çedomir Aksiqit dhe gjatë shqyrtimit kryesor, në cilësinë e dëshmitarit, të dëgjohen dymbëdhjetë (12) persona.

AKTGJYKIMI I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË/PRIŠTINA

Trupi gjykues i Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, në rastin Prokurori kundër Çedomir Aksiqin, në datën 26 dhjetor 2024 e shpalli aktgjykimin me të cilin të pandehurin Aksiq e shpalli fajtor dhe e dënoi me 15 vite burgim për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.

Trupi gjykues vërtetoi se i pandehuri Çedomir Aksiq në periudhën kohore prej muajit janar-maj 1999, në bashkëkryerje me pjesëtarë tjerë të forcave serbe ka shkaktuar vuajtje të mëdha dhe cenim të integritetit trupor ose shëndetit, frikësimin ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, urdhërim për zhvendosjen e popullatës civile për shkaqe që lidhen me konfliktin dhe luftën drejtuar me qëllim kundër popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civile që nuk marrin pjesë drejtpërdrejtë në konflikt, ashtu që gjatë konfliktit të armatosur me karakter jo ndërkombëtarë të zhvilluar në mes të UÇK dhe forcave ushtarake të RFJ-së dhe forcave policore të Serbisë me dashje i shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare kundër personave civilë, ashtu që:

- Në fillim të prillit 1999, i pandehuri Çedomir Aksiq, në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, fillimisht urdhëroi dëbimin e banorëve nga një zonë në afërsi të Shtimes/Štimlje. Pas dëbimit me dhunë të popullatës civile, ai mori pjesë në vendosjen e eksplozivit për djegien e shtëpive të shtëpive të Ruzhdi Jashari, Sadri Jashari, Rexhep Jashari dhe Hamdi Jashari në rrugën "Sylejman Vokshi" në Shtime/Štimlje, duke u shkaktuar atyre dëme të mëdha materiale dhe morale, në vlerë rreth 300,000 euro.

- Më 13-14 maj 1999, në fshatin Petrovë/Petrovo të Shtimes, Çedomir Aksiq, së bashku me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe, ndaloi dhe mori me vete Halil Hysenaj, i cili ishte larguar për të parë nëse forcat që po afroreshin ishin të UÇK-së apo serbe. Të nesërmen, Halil Hysenaj u gjet i vvarë në një gropë të cekët në fshat, duke i shkaktuar familjes së tij vuajtje të mëdha shpirtërore dhe dëme materiale e morale.

- Më 15 janar 1999, në fshatin Reçak/Raçak të Shtimes, Çedomir Aksiq, në bashkëkryerje me forca të tjera serbe, mori pjesë në sulme të armatosura ndaj civilëve shqiptarë që po largoheshin nga shtëpitë e tyre. Gjatë këtyre sulmeve, ai dhe grupi i tij vranë Hajriz Brahimin, Haki Muratin, Sabri Muratin, Arif Muratin, Ahmet Mustafën, Sadik Mujotën, Hanumshahe Mujotën Skender Halilin dhe Mehmet Mustafën. Si pasojë, familjet e tyre pësuan vuajtje të mëdha shpirtërore dhe dëme materiale e morale.

AKTVENDIMI I GJYKATËS SË APELIT (KTHIMI I RASTIT NË RIGJYKIM)

Gjykata e Apelit në datën 10 nëntor 2025 e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës/Priština me të cilin është dënuar me 15 vite burgim i pandehuri Çedomir Aksiq për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.

Aktgjykimi i shkallës së parë është prishur për arsye se kolegji i apelit vlerësoi se gjykimi në mungesë – shqyrtimi gjyqësorë është zhvilluar pa u përmbushur kushtet ligjore, përkatësisht pa u ndërmarrë përpjekje të arsyeshme për njoftimin e të akuzuarit për shqyrtimin gjyqësor dhe për sigurimin e pranisë së tij. Gjithashtu sipas kolegjit, gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar tërësisht zhvillimin e një fushate informative të plotë, e cila paraqet një nga kushtet kumulative të parapara me nenin 303 të KPPRK-së.

2. PROKURORI KUNDËR IVICA RAJKOVIQIT DHE DRAGAN DENIQIT

Gjykata Themelore e Prishtinës/Priština në datën 27 gusht 2025 e ka shpallur aktgjykimin në rastin Prokurori kundër Ivica Rajkoviqit dhe Dragan Deniqit me të cilin të pandehurit janë dënuar me nga 15 vite burgim, secili veç e veç, për veprën penale dhunim seksual si krim i luftës kundër popullatës civile.

RRJEDHA E PROCEDURËS

Në datën 14 shtator 2023, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) e ka ngritur aktakuzën për gjykim në mungesë kundër Ivica Rajkoviqin dhe Dragan Deniqin për veprën penale dhunim seksual si krim i luftës kundër popullatës civile.

Të pandehurit Rajkoviq dhe Deniq akuzohen se, si pjesëtarë të forcave të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) të Serbisë, gjatë luftës në Kosovë, më muajin maj 1999, në orët e mesditës në Prishtinë/Priština, të uniformuar dhe të armatosur, së bashku me persona të tjerë ende të paid-entifikuar, kanë rrahur, plaçkitur dhe keqtrajtuar banorët e një lagjeje të Prishtinës/Priština. Po ashtu, të pandehurit dyshohen se kanë hyrë në shtëpinë e viktimës D.I., ku, me forcë, e kanë dhunuar atë së bashku me persona të tjerë.

Prokuroria ka propozuar që pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština të mbahet gjykimi në mungesë kundër të pandehurve Rajkoviq dhe Deniq dhe gjatë shqyrtimit kryesor, në cilësinë e dëshmitarit, të dëgjohet e dëmtuara D.I. dhe nëntë (9) dëshmitarë të tjerë.

AKTGJYKIMI I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË/PRIŠTINA

Trupi gjykues i Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, në rastin Prokurori kundër Ivica Rajkovićin dhe Dragan Deniqin, në datën 27 gusht 2025 e shpalli aktgjykimin me të cilin të pandehurit i shpalli fajtor dhe i dënoi me nga 15 vite burgim, secilin veç e veç, për veprën penale dhunim seksual si krim i luftës kundër popullatës civile.

Trupi gjykues vërtetoi se të pandehurit, si pjesëtarë të forcave policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, gjatë luftës në Kosovë dhe në bashkëkryerje me persona të tjerë, kanë kryer dhunim seksual ndaj një gruaje të kombësisë shqiptare. Saktësisht, gjatë muajit maj 1999, në një lagje të komunës së Prishtinës/Priština, të pandehurit Rajković dhe Deniq, të uniformuar dhe të armatosur, së bashku me persona të tjerë ende të paidentifikuar, hynë në shtëpinë e viktimës D.I. dhe e dhunuan atë, duke i shkaktuar trauma të rënda fizike dhe psikike.

Ky rast ende nuk ka marrë formë të prerë, pasi që ndodhet në Gjykatën e Apelit për shqyrtim, pas parashtrimit të mjeteve juridike kundër aktgjykimin të shkallës së parë.

3. PROKURORI KUNDËR SLLAVISHA FILLIQIT

Trupi gjykues i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, më 17 korrik 2025, e ka shpallur aktgjykimin me të cilin i pandehuri Sllavisha Filliq është shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 15 vite burgim për kryerjen e veprës penale krim i luftës kundër popullatës civile.

RRJEDHA E PROCEDURËS

Në datën 15 shtator 2023, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) e ka ngritur aktakuzën për gjykim në mungesë kundër Sllavisha Filliqit për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.

I pandehuri Sllavisha Filliq akuzohet se, në cilësinë e pjesëtarit të sigurimit shtetëror të Serbisë, së bashku me dy zyrtarë të tjerë të këtij shërbimi, ende të panjohur për organet e ndjekjes, më 10 prill 1998, në rrugën Drenas/Glogovac – Prishtinë/Priština, tek udhëkryqi i Sllatinës/Slatina, kanë ndaluar veturën në të cilën ndodheshin mjeku Hafir Shala dhe dy persona të tjerë. Pas legjitimit nga policia serbe dhe pjesëtarë të sigurimit shtetëror, i pandehuri dhe dy pjesëtarë të sigurimit shtetëror e kanë marrë me forcë mjekun Hafir Shala dhe e kanë dërguar në ndërtesën e sigurimit shtetëror në Prishtinë/Priština. Atje, ai i është nënshtruar rrahjeve dhe torturave, dhe nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e tij.

Prokuroria ka propozuar që pranë Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština të mbahet gjykimin në mungesë kundër të pandehurit Sllavisha Filliqit dhe gjatë shqyrtimit kryesor, në cilësinë e dëshmitarit, të dëgjohen gjashtëmbëdhjetë (16) persona.

AKTGJYKIM I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË/PRIŠTINA

Trupi gjykues vërtetoi se më 10 prill 1998, në bashkëkryerje me dy pjesëtarë të tjerë të panjohur, në cilësinë e personave zyrtarë dhe si pjesëtarë të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, afër aeroportit të Prishtinës/Priština, në rrugën Drenas/Glogovac-Prishtinë/Priština, tek udhëkryqi i Sllatinës/Slatina, kanë ndaluar veturën në të cilën ndodheshin viktimat Hafir Shala, mjek me profesion, dhe dy persona të tjerë. Pas legjitimit nga ana e policisë, viktimat Hafir Shala u mor nga i pandehuri Sllavisha Filliq dhe dy personat e tjerë të panjohur, të tre të veshur me rroba civile. Ata e futën të njëjtin në veturën që drejtohej nga i pandehuri dhe e dërguan në ndërtesën e Sigurimit Shtetëror në Prishtinë/Priština, ku fillimisht u nënshtrua rrahjeve dhe torturave, dhe që nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e tij.

Ky rast ende nuk ka marrë formë të prerë, pasi që ndodhet në Gjykatën e Apelit për shqyrtim, pas parashtrimit të mjeteve juridike kundër aktgjyqimit të shkallës së parë

GJETJET E FDHK:

-Vendimi i Apelit në rastin Prokurori kundër Çedomir Aksiqin thekson nevojën për respektimin rigoroz të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht në gjykimet në mungesë. Ky vendim shërben si udhërrëfyes për gjykatat më të ulëta që të sigurojnë procedurën të rregullta dhe mbrojtje efektive të të drejtave të të pandehurve.

-Duke pasur parasysh se në tri vitet e fundit janë akuzuar mbi 120 persona në mungesë, kjo formë e gjyqimit nuk duhet të bëhet praktikë dominuese. Për të garantuar drejtësi më të plotë dhe praninë e të akuzuarve, kërkohet bashkëpunim më i madh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë përmes marrëveshjeve konkrete, me rol aktiv të bashkësisë ndërkombëtare në nxitjen e këtij bashkëpunimi.

-Në përgjithësi në rastet e krimeve të luftës, gjykatat duhet të shmangin përgjithësimin e veprimeve kriminale në nivel grupi dhe të sigurojnë që çdo i pandehur të gjykohet vetëm për veprimet e tij konkrete. Çdo fajësi duhet të mbështetet në prova bindëse, përtej dyshimit të arsyeshëm, duke respektuar parimin e përgjegjësisë individuale penale.

Projekti “Ballafaqimi me Trashëgiminë e Konfliktit” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



British Embassy
Pristina



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo